

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“DOKO ENERGY” sh.p.k.**

Sot, me date 02/03/2023, ortaku i vetem themelues:

Erlir Doko, lindur në Elbasan, më 21.07.1992, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, rezident ne Elbasan, identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal J207211160,

Ka vendosur te themelojne shoqërinë tregtare “DOKO ENERGY” sh.p.k, me kushtet si më poshtë:

**NENI 1
Statusi Juridik**

Shoqëria Tregtare “**DOKO ENERGY**” sh.p.k. është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (në vazhdim referuar si “Shoqëria”). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 2
Emri i shoqërisë**

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**DOKO ENERGY**” sh.p.k.

**NENI 3
Objekti i veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarise së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

Projektim, furnizim, ndertim, testim per linjat elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te lart. Projektim, furnizim, ndertim, testim per nenstacionet elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te lart. Projektim, furnizim, ndertim, testim per Hidrocentrale. Projektim, furnizim, ndertim , testim per Termocentrale. Projektim, furnizim, Ndertim , testim per impiante Eolik. Projektim, furnizim, ndertim , testim per impiante Fotovoltaike dhe cdo lloj impianti qe sherben per prodhimin e energjise elektrike. Projektim, furnizim, prodhim ,testim te githa llojeve te kontruksioneve metalike. Veprimtari ne fushen e ndertimit si: Projektim e zbatim, germime dheu, murature betoni, sistemime terrenesh, prodhim materiale ndertimi, ndertime civile industriale etj. Ndertim rruge, vepra arti, ura, kanalizime, hekurudha etj, ndertime detare, hidraulike e hidroteknike, vepra te vecanta e punime speciale, Punime restaurimi, e punime



karpentiere druri metalike, punime montimi ne impiantet e prodhimit te shperdarjes se energjise, impiante teknologjike te vecanta, punime sherbimi, punime topogjezike, instalim te paisjeve fundore te telekomunikacionit, punime ne shfrytezim minerar dhe shpime ne thellesi me marrje kampioni per studim gjeologjik, Tregti te materialeve te ndertimit, energjise etj, Si dhe cdo aktivitet tjeter fitimprures dhe ne interes te shoqerise. Ndertim dhe ofrim i rrjeteve publike dhe private te telekomunikacionit. Perdorimi civil i lendeve plasese. Transport nderkombetar i udhetareve. Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve (kapaciteti: Te gjitha instalimet).

NENI 4 **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Elbasan, Bradashesh, Rruga Europa, ZK Nr.2124 numër pasurie 75/27.

NENI 5 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqerisë është në vlerën 100 000 leke, i perbere nga 1 (nje) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100 000 leke.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total.

NENI 6 **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Afat kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaku i Shoqërisë mund të vendosë kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7 **Organet Drejtuese**

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqerisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund te zgjidhen për një afat deri ne pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "**DOKO ENERGY**" sh.p.k, do të jetë Erlir Doko, lindur në 21.07.1992, më Elbasan, identifikuar nga karta e identitetit me nr. J207211160., resident



ne adresen L.Dyli Haxhire Myzyri,Elbasan, i cili zgjidhet per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Shoqeria do të përfaqësohet përpara cdo organi administrativ, gjyqësor, apo cdo entiteti tjeter publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8
Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit i firmosur nga Ortaku Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet pa verejtje nga Ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Erlir Doko

